



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

BULETINI MUJOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

Korrik, 2026

PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Numri i rasteve dhe vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse gjatë muajit korrik 2026
2. Sëmundjet ngjitëse të raportuara në Kosovë, forma e agreguar dhe individuale
3. Rastet e spitalizuara nga sëmundjet ngjitëse
4. Epidemitë e lajmëruara
5. Niveli i raportimit nga institucionet shëndetësore
6. Situata epidemiologjike në rajon dhe botë

QËLLIMI:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përf forcimit të parandalimit dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. NUMRI I RASTEVE DHE VDEKJEVE NGA SËMUNDJET NGJITËSE GJATË MUAJIT KORRIK 2026

Gjatë muajit korrik 2026 janë raportuar 13,092 raste me sëmundje ngjitëse apo Incidencë (817.0 raste /100, 000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 (16,916 raste apo Incidencë 1,055.59 raste/100,000). Sëmundjet të cilat prijnë me numër më të lartë të rasteve janë: Diarea ac. me 9,755 raste ose Inc. 608.7/100,000 banorë dhe Influenca sezonale (ILI) me 2,209 raste ose Inc. 137.8/100,000. (Tab.1).

Gjatë muajit korrik 2026 janë raportuar 3 raste të vdekjes nga sëmundjet ngjitëse: 2 raste me dg. Infiltratio Pulmonum me diagnozë përcjellëse dhe 1 rast me dg. AIDS.

Tabela 1. Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse/ shkaktarëve të raportuar në Kosovë, korrik 2026 krahasuar me korrik 2025

Sëmundjet /shkaktarët	Korrik 2026		Korrik 2025	
	Nr. i rasteve	Incidenca/100,000	Nr. i rasteve	Incidenca/100,000
ARI (Infeksion akut respirator)	307	19.2	713	44.5
SARI (Infeksion i rëndë akut respirator)	26	1.6	14	0.9
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	2,209	137.8	4,121	257.2
RSV		0.0		0.0
COVID 19	20	1.2	9	0.6
Influenca A		0.0		0.0
Diarea acute	9,755	608.7	11,216	699.9
Variçela	278	17.3	404	25.2
Sindromi meningjeal	23	1.4	19	1.2
Helmimet me ushqim	182	11.4	142	8.9
E.coli	1	0.1	1	0.1
Salmonella enteritidis	29	1.8	5	0.3
Infeksionet virale dhe infeksionet tjera specifike intestinale dhe me Rotavirus	10	0.6	10	0.6
Gastroenterokolitet	54	3.4	111	6.9
Hepatiti akut B	1	0.1	2	0.1
Hepatiti akut C		0.0	1	0.1
Morbilli	45	2.8	19	1.2
Parotiti epidemik	2	0.1	3	0.2
Pertussis	2	0.1		0.0
Rubella	1	0.1	1	0.1
Tularemia	3	0.2	1	0.1
Brucelosis	5	0.3	8	0.5
Echinococcus		0.0		0.0
Sëmundja Lyme	1	0.1	4	0.2
Toxoplasmosis		0.0	1	0.1
Leishmaniazë	1	0.1		0.0
Legionella	1	0.1		
HIV/AIDS	6	0.4	5	0.3
TB (Tuberkuloza)	41	2.6	24	1.5
IST	20	1.2	29	1.8
Cl.Difficile	3	0.2	3	0.2
Giardiaza	8	0.5	2	0.1
Infeksionet streptokoksike të grupit A	28	1.7	5	0.3
*Sëmundjet tjera ngjitëse	30	1.9	43	2.7
Gjithsej	13,092	817.0	16,916	1,055.59

*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

1. SËMUNDJET NGJITËSE TË RAPORTUARA NË KOSOVË, KORRIK 2026

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën e agreguar

Diarea akute: Gjatë muajit korrik 2026 në IKShPK janë raportuar 9,755 raste me Diare akute (Inc.608.7/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (11,216 raste), vërehet ulje prej 13.03% por krahasuar me muajin paraprak, me 3,989 raste të raportuara, rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve të raportuara. Megjithatë, numër ky i konsideruar i rasteve të raportuara i cili mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë dhe kushteve të ruajtjes dhe përgatitjes së ushqimit.

Influenca sezonale /ILI: Gjatë muajit korrik 2026 në IKShPK janë raportuar 2,209 raste me ILI (Inc. 137.8/100,000 banorë). Sipas numrit të rasteve të raportuara vërehet një ulje prej 46.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak me (4,121 raste të raportuara), por krahasuar me muajin paraprak, qershor 2026 me (1,976 raste të raportuara me ILI) vërehet rritje prej 11.8% e numrit të rasteve të raportuara.

Infeksion akut respirator (ARI) : Gjatë muajit korrik 2026 në IKShPK janë raportuar 307 raste me ARI (Inc.19.2/100,000 banorë). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak me (713 raste) vërehet rritje prej 56.9% e rasteve të raportuara dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak qershor 2026 me (195 raste) rritje për 57.4%.

Variçella: Gjatë muajit korrik 2026 në IKShPK janë raportuar 278 raste me Variçellë (Inc.17.3/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (404 raste) vërehet ulje prej 31.2% dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak qershor 2026 me 476 raste të raportuara, rënie e konsiderueshme e numrit të rasteve të raportuara.

Grupi i sëmundjeve që raportohen me formën individuale:

Sëmundjet vaksinëparandaluese

Gjatë muajit korrik, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) është vërejtur një rritje e numrit të rasteve të raportuara me fruth. Gjatë kësaj periudhe janë raportuar gjithsej 45 raste të konfirmuara në laborator.

Komuna e Fushë Kosovës paraqet përqëndrimin më të lartë të rasteve me 17 raste (39%), pasuar nga komuna e Prishtinës me 16 raste ose 36%, komuna e Drenasit, Obiliqit dhe e Skenderajit me nga 2 raste secila si dhe me nga 1 rast komunat: Podujevë, Gjiilan, Lipjan, Kaçanik, Graçanicë dhe Shtërpce. Sipas grup-moshave, 19 raste i përket grup-moshës 12-24 muaj, 9 raste grup-moshës 0-12 muaj, 8 raste grup-moshës 2-4 vjeç, me nga 3 raste grup-moshat 4-6 vjeç, 6-18 vjeç dhe mbi 18 vjeç. Sipas gjinisë, 24 raste i takojnë gjinisë mashkullore dhe 21 raste gjinisë femërore. Sa i përket statusit vaksinal, 43 prej rasteve (95,5%) të pavaksinuara me vaksinën MMR. Poashtu, vlen të theksohet se 21 prej rasteve (ose 48%) vijnë institucionet parashkollore.

Gjatë muajit korrik janë raportuar gjithashtu 2 raste me parotit dhe 2 të tjera me pertussis. Sipas komunave 2 rastet me parotit janë nga komuna e Prishtinës. Sipas grup-moshës 1 rast i takon grup-moshës 5-9 vjeç, dhe 1 rast grup-moshës mbi 18 vjeç. Të dy rastet, të pavaksinuara me vaksinën MMR.

Rastet me pertussis, sipas komunave: Fushë Kosovë (1 rast) dhe Skenderaj (1 rast). Sipas grup-moshës: 1 rast 4-6 vjeç dhe 1 rast 6-18 vjeç. Sipas statusit vaksinal, një rast me status të rregullt vaksinal sipas kalendarit të rregullt të vaksinimit, kurse rasti tjetër është i pavaksinuar me vaksinën MMR.

Nga të gjitha mostrat e testuara në laboratorin mikrobiologjik të IKShPK-së raste të dyshimta për rubella, vetëm një rast ka rezultuar pozitiv. Rasti i përket komunës së Prishtinës, gjinisë mashkullore, grup-moshës 4-6 vjeç.

Zoonozat dhe sëmundjet transmise

Gjatë muajit korrik 2026, nga laboratori i Mikrobiologjisë (IKShPK), janë raportuar 5 raste pozitive me Brucellozë. Sipas komunave: Dragash, Klinë, Malishevë, Prizren dhe Shtërpce, me nga 1 rast. Sipas grup moshave: 2 raste të grup-moshës 30–39 vjeç, dhe me nga 1 rast grup-moshat: 20-29, 50-59 dhe 70+vjeç. Sipas gjinisë, 4 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 1 rast i gjinisë femërore.

Nga të dhënat e hulumtimit epidemiologjik rezulton se 4 nga rastet kanë pasur kontakt direkt me kafshë, pra manipulimit me lindjet apo abortet pa masa mbrojtëse, si dhe 1 prej rasteve si pasojë e konsumit të produkteve të qumështit të papasterizuara dhe mishit.

Gjithashtu gjatë muajit korrik 2026 nga grupi i zoonozave, janë raportuar gjithsej 3 raste me tularemi. Sipas komunave: Ferizaj, Shtime, dhe Vushtrri me nga 1 rast. Për nga grup-mosha, me nga 1 rast i raportuar nga 40–49 vjeç, 50–59 vjeç dhe 60–69 vjeç. Sipas gjinisë, 2 raste të gjinisë mashkullore dhe 1 të asaj femërore. Bazuar në hulumtimin epidemiologjik të vatrave endemike për tularemi, prania e brejtësve në ambientet e banimit ose në stallat e kafshëve si dhe përdorimi i ujit nga burime të pakontrolluara, si bunarët dhe burimet natyrore si rrugë e mundshme e përhapjes së infeksionit.

Nga grupi i sëmundjeve transmise, gjatë muajit korrik 2026 është raportuar 1 rast pozitiv me Leishmaniazë dhe 1 rast pozitiv me Borreliozë. Rasti i raportuar me leishmaniazë me vendbanim në Rahovec, i grup-moshës 50–59 vjeç dhe me gjini mashkullore. Bazuar në hulumtimin epidemiologjik, rasti ka histori të udhëtimit në qytetin e Bajram Currit në Shqipëri një javë para fillimit të simptomave. Nuk raporton kontakt të drejtpërdrejtë me kafshë dhe mohon pickimin nga insektet, megjithëse deklaroi se në zonën ku banon gjatë muajve të verës ka prani të insekteve.

Rasti pozitiv me borreliozë, me vendbanim në Podujevë i grup-moshës 20–29 vjeç dhe i përket gjinisë mashkullore. Rasti ka rezultuar IgM pozitiv dhe është trajtuar në mënyrë ambulantore. Sipas hulumtimit epidemiologjik, rasti deklaroi se është pickuar nga rriqërat gjatë qëndrimit në oborrin e shtëpisë.

Gjatë kësaj periudhe është raportuar një rast me Legionella pneumophila, nga komuna e Prishtinës dhe grup-moshë 40-45 vjeç, rast ky i cili është në hulumtim epidemiologjik.

Sindroma meningjeale

Gjatë muajit korrik, 2026 janë raportuar gjithsej 23 raste me Sindromën Meningjeale (Mb. 1.44/100,000 banorë), Prej tyre, 16 raste me diagnozën Meningitis acuta, 3 raste me diagnozën Meningitis acuta serosa, 2 raste me diagnozën Meningitis acuta purulenta dhe 2 raste me diagnozën Meningoencephalitis. Numri i rasteve të raportuara është më i lartë krahasuar me të njëjtin muaj të vitit paraprak (qershor, 2025), ku ishin raportuar 19 raste (Inc. 1.07/100,000 banorë). Numri më i madh i rasteve të raportuara sipas komunave është regjistruar në Prishtinë me 7 raste, pasuar nga Fushë Kosova dhe Malisheva me nga 3 raste, Kaçaniku me 2 raste, ndërsa me nga 1 rast janë regjistruar komunat: Ferizaj, Gjilan, Istog, Lipjan, Mitrovicë, Pejë, Skenderaj dhe Viti.

Sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshës, gjatë kësaj periudhe numri më i madh i rasteve është raportuar në grup-moshën 0-9 vjeç me 10 raste (43%), pastaj grupmosha 10-19 vjeç me 4 raste (17%), grupmosha 30-39 vjeç me 3 raste (13%), duke vazhduar me grupmoshat 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç, me nga 2 raste (9%) dhe grupmoshat, 70-79 vjeç dhe 80+ vjeç me nga 1 rast (4%). Ndërsa, nuk ka raportime nga grup-moshat tjera.

Sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë, 52% (12 raste) i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 48% (11 raste) i takojnë gjinisë mashkullore.

Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKSHPK përmes sistemit MedLIS, si dhe në laboratorin mikrobiologjik të Klinikës Infektive, janë identifikuar disa shkaktarë viralë dhe bakterialë në lëngun cerebrospinal (LCS). Gjithsej janë raportuar 14 raste me izolime pozitive. Shkaktarët viralë të identifikuar janë: 5 raste me Human Enterovirus, 3 raste me Mumps virus, 2 raste me HHV7 dhe 1 rast me Citomegalovirus. Ndërsa nga shkaktarët bakterialë janë identifikuar me nga 1 rast Streptococcus pneumoniae, Staphylococcus epidermidis dhe Enterococcus faecalis.

Sëmundjet që barten me ujë dhe ushqim

Gjatë muajit qershor 2026, krahas sëmundjeve që raportohen në formën e agreguar janë raportuar gjithashtu edhe 182 raste me Helmim me ushqim dhe 54 raste me Gastroenterokolit.

Sipas shkaktarëve të izoluar në Laboratorin e Mikrobiologjisë në IKSHPK dhe Kl. Infektive janë raportuar: 29 raste të konfirmuara me Salmonella enteritidis. Sipas komunave; 19 raste nga komuna e Prishtinës, 5 raste komuna e Hani Elezit, 2 raste nga komuna e Malisheves dhe me nga një rast nga komunat: Fushë Kosovë, Rahovec dhe Lipjan. Sipas grup moshës: 11 raste nga grup mosha 20-29 vjeç, 9 raste nga grup mosha 10-19 vjeç, 2 raste nga grup mosha 40-49 vjeç, 2 raste nga grup mosha 50-59 vjeç dhe me 3 raste nga grup mosha mbi 65 vjeç. Sipas gjinisë 17 raste janë të gjinisë femërore dhe 11 raste të gjinisë mashkullore. *shih seksionin epidemitë në Kosovë.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë raportuar 4 raste me Rotavirus. Sipas komunave: me nga një rast raportohen nga komuna e Pejës, Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Istogut. Sipas grup moshës: 4 rastet i takojnë grup moshës 0-9 vjeç dhe sipas gjinisë: 3 raste të gjinisë mashkullore dhe 1 rast i gjinisë femërore.

Nga shkaktarët e tjerë të raportuar gjatë kësaj periudhe janë: 5 raste me Giardia lamblia. Sipas komunave: 2 raste nga komuna e Gjakovës dhe 1 rast nga komuna e Prishtinës, Ferizajit dhe ajo e Pejës. Sipas grup moshave: 2 raste nga grup mosha 40-49 vjeç dhe me nga 1 rast grup moshat 0-9, 10-19 dhe 20-29 vjeç; 3 raste me Clostridium difficile. Sipas komunave: 2 raste nga komuna e Prishtinës dhe 1 rast nga komuna e Podujevës. Sipas grup moshës: me nga 1 rast nga grup moshat: 10-19, 30-39 dhe 50-59 vjeç, kurse sipas gjinisë: 2 raste nga gjinia mashkullore dhe 1 rast nga gjinia femërore; 5 raste me Adenovirus. Sipas komunave: 2 raste nga komuna e Mitrovicës dhe me nga 1 rast komunat: Rahovec, Gjakovë dhe Istog. Sipas grup moshës: të gjitha rastet e raportuara i takojnë grup moshës 0-9 vjeç dhe sipas gjinisë: 5 rastet i takojnë gjinisë mashkullore; 1 rast me Enterovirus, nga komuna e Vitisë, grup mosha 10-19 vjeç, i gjinisë mashkullore; 1 rast me Echeria Coli nga komuna e Prishtinës. Rasti i përket grup moshës mbi 60 vjeç dhe është i gjinisë mashkullore; 21 raste me Ascaris lumbricoides. Sipas komunave: 7 raste nga komuna e Ferizajit, 5 raste nga komuna e Gjakovës, 4 raste nga komuna e Prizrenit, 2 raste nga komuna e Prishtinës dhe me nga 1 rast të raportuar nga komunat: Rahovec, Lipjan dhe Shtërpce. Sipas grup moshës: 10 raste nga grup mosha 0-9 vjeç, 7 raste nga grup mosha mbi 60 vjeç, 2 raste nga grup mosha 50-59 vjeç, dhe me nga 1 rast grup moshat: 30-39 dhe 40-49 vjeç. Sipas gjinisë: 15 raste i përkasin gjinisë femërore dhe 6 raste gjinisë mashkullore.

Sëmundjet/Infeksionet respiratore

Gjatë muajit korrik 2026, janë testuar gjithsej 196 mostra të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respirator dhe SARS-CoV-2, të përzgjedhura nga qendrat sentinel. Nga mostrat e testuara janë konfirmuar 20 raste me SARS-CoV-2 apo pozitivitet prej 10.2%. Nga patogjenët tjerë respiratorë janë raportuar 28 (14.3%) mostra pozitive në Human Rhinovirus, 17 (8.7%) mostra pozitive në Human Adenovirus dhe 12 (6.1%) mostra pozitive në Human parainfluenza virus.

Rastet pozitive të konfirmuara me SARS-CoV-2 sipas komunave: Prishtinë (7 raste), Fushë Kosovë (5 raste), Skenderaj (2 raste); dhe me nga 1 rast komunat: Ferizaj, Suharekë, Prizren, Malishevë dhe Mitrovicë. Sipas grupmoshës, me SARS-CoV-2: 9 prej tyre i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç, 4 raste të grup moshës 5-14 vjeç, me nga 2 raste grup-moshat: 35-50 vjeç, 51-64 vjeç dhe 65+, dhe 1 rast nga grup moshë 15-34 vjeç. Nga 20 rastet e raportura, 5 prej tyre janë raportuar nga Klinika Infektive (2 në Mjekim Intensiv), 6 nga Klinika e Pediatriisë nga Klinika e Kardiologjisë, 1 nga Klinika e Hematologjisë dhe të tjera si raste ambulatore.

Gjatë muajit korrik 2026, përmes Sistemit të Mbikqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN), u raportuan gjithsej 26 raste me SARI (Inc.1.46/100,000 banorë) dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025 me (14 raste) vërehet rritje e ndjeshme e numrit të rasteve dhe gjithashtu krahasuar me muajin paraprak (23 raste), vërehet rritje prej 13% e numrit të rasteve. Prej tyre 12 apo 46.2% nuk u testuan në asnjë nga viruset respiratore ndërsa 14 apo 53.8% prej tyre, sipas protokollit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influcencë dhe RSV. Rastet SARI sipas komunave janë: Prishtinë (6 raste), Podujevë (3 raste), Drenas (3 raste), Lipjan (2 raste), Malishevë (2 raste), Skenderaj (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Gjakovë, Klinë, Mitrovicë, Prizren, Viti dhe Vushtrri. Numri më i lartë i rasteve SARI sipas grup moshës është : mbi 65 vjeç (11 raste), 0-4 vjeç (5 raste), 51-64 vjeç (4 raste), 5-14 vjeç (3 raste), 35-50 vjeç (2 raste) dhe 15-34 vjeç (1 rast). Sipas gjinisë, 17 prej tyre i takojnë gjinisë mashkullore dhe 9 gjinisë femërore. Nga të gjitha rastet SARI, 4 apo 15.4% prej tyre ishin të vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Gjatë muajit korrik 2026, janë raportuar 2 raste të vdekjes nga SARI (CFR= 7.8%). Rastet e vdekjes nga SARI i takojnë grup-moshës 65+, 1 i gjinisë mashkullore dhe 1 gjinisë femërore, nga komunat: Prishtinë dhe Malishevë, me sëmundje përcjellëse dhe asnjëri prej tyre nuk është i vaksinuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Nga të gjitha rastet e raportuara SARI, në Klinikën Infektive u hospitalizuan 16 raste, ndërsa në Klinikën e Pediatriisë 9 raste (të gjitha nga reparti i Pulmologjisë), ku 2 prej tyre u pranuan në Njësinë e Mjekimit Intensiv.

Ecuria me Tuberkuloz

Në SMSN, gjatë muajit korrik 2026, janë raportuar 41 raste me Tuberkuloz apo 2.55 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Ferizaj (9 raste), Prishtinë (5 raste), kurse Prizreni dhe Suhareka me nga (4 raste), me nga 3 raste komunat: Pejë dhe Rahovec, me nga 2 raste komunat: Gjakovë dhe Istog, me nga (1 rast) komunat: Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Lipjan, Malishevë, Viti, Drenas, Vushtrri dhe Shtërpçë. Prej 41 rasteve të raportuara, 32 (78.1%) janë raste pulmonare dhe forma ekstra-pulmonare 9 (21.9%).

Gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup-moshat më të prekura janë grup-moshat 55–59 vjeç me nga (10 raste), 60–69 vjeç (8 raste), 75–79 vjeç (6 raste), 40–49 vjeç me nga (5 raste) mbi 80 vjeç (3 raste) kurse grup-moshat 10-19 vjeç dhe 30–39 vjeç me nga 2 raste. Sipas gjinisë, rezulton se 53.6% (22 raste) i takojnë gjinisë mashkullore ndërsa gjinia femërore me 46.3% (19 raste).

Rastet me HIV/AIDS/IST, korrik 2026

Gjatë muajit korrik 2026, janë raportuar 6 raste me HIV/AIDS. Sipas gjinisë, të gjitha rastet i përkasin gjinisë mashkullore. Në aspektin gjeografik rastet janë: me nga dy (2) raste komuna e Gjakovës dhe Prishtinës, ndërsa nga një (1) rast nga komuna e Gjilanit dhe Mitrovicës. Sipas grup moshës, një (1) rast 15-24 vjeç, dy (2) raste i përkasin grup moshës 25-34 vjeç, dy (2) raste 45-54 vjeç dhe një (1) i grup moshës mbi 50 vjeç.

Në muajin korrik është raportuar një (1) rast i vdekjes nga AIDS. Rasti është i gjinisë mashkullore, i grup moshës 45-54 vjeç nga komuna e Mitrovicës.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST), korrik 2026

Gjatë muajit korrik 2026 janë raportuar gjithsej 20 raste me Infeksione Seksualisht të Transmetueshme. Rastet e raportuara janë nga komunat: Ferizaj 6, Prishtinë 2, Prizren 4, Vushtrri 3, Podujevë 2, dhe me nga një (1) rast komunat Pejë, Deçan, Drenas. Sipas diagnozës: Condyloma 12, Chlamydia 7 raste dhe Sifiliz 1 rast. Sipas gjinisë: 11 raste (55%) i takojnë gjinisë mashkullore dhe 9 raste (45%) gjinisë femërore. Sipas grup moshës: 15-24 vjeç 3 raste (15%), 25-49 vjeç 14 raste (70%) dhe 50+ 3 raste (15%).

Hepatiti akut B dhe Hepatiti akut C

Gjatë muajit korrik 2026 është raportuar 1 rast (Mb. 0.06/100 000 banorë) me diagnozën Hepatit akut B, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kur janë raportuar 2 raste me Hepatit akut B (Mb. 0.11/100 000 banorë). Rasti i raportuar është i gjinisë mashkullore, i moshës 37 vjeçare, nga komuna e Prizrenit.

Sa i përket Hepatitit akut C, gjatë muajit korrik 2026 nuk është raportuar asnjë rast (Mb. 0.00/100 000 banorë), krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kur është raportuar 1 rast me Hepatit akut C (Mb. 0.06/100 000 banorë).

Gjatë kësaj periudhe nuk është raportuar asnjë rast vdekjeje me Hepatit akut B ose C.

Tabela 2. Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë sipas komunave, korrik 2026

Annex 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse sipas komunave, Korrik _2026																																				
SËMUNDJA	Pneumonia/ ARI	SARI	ILI	Diarrhea ac	Varicella	COVID- 19	Sindroma meningjeale			**Morbil i	Parotitis epidemic a	Pertussis	Rubella	Hepatit ac. B	Helmint me ushqim	Gastroen terokolit et	Bruceloz a	Tularemi	Salmon elloza	E.coli	Rotaviru s	Borelioz a (Lyme Disease)	Adenovir us	Enterovi sus	Leishma niaza	Cl.difficil e	Legionell a	IST	HIV	TB	Giardiaz a	Infeksionet streptokok sike të gr. A	Sëm.tjera ngjitëse	Gjithshj		
KOMUNA							Meningjit serosa	Meningji t purulent	Meningo encephal it ac.																											
DEÇAN	6		9	201	5										15													1						237		
DRAGASH	6		18	150	4										1		1																2	182		
DRENAS	2	3	5	80	6	1				2						1												1		1				1	103	
F. KOSOVË	1	1	19	259	13	5	2	1		17		1				2			1																322	
FERIZAJ	19	1	217	724	15	1	1									29		1										6		9	1			7	1031	
GJAKOVË	4	1	26	160	18										7								1							2	2	5	28	5	259	
GJILAN	5		30	415	12			1			1																			1					465	
GRAÇANICË										1																										1
H.I.ELEZIT			12	146	3										4	4				5															174	
ISTOG	10		71	137				1							6							1									2				229	
JUNIK				33											3																					36
KAÇANIK	1		59	150	2			2			1					2																1			218	
KAMENICË			100	348											1																	1			450	
KLINË	27	1	107	161	14										4		1															1			316	
KILOKOT																																				0
LEPOSAVIQ																																				0
LIPJAN		2	7	25	2			1			1					1				1												1			42	
MALISHEVË		2	47	123			1	2		1						1	1			2												1			181	
MAMUSHË			3	36																																39
MITROVICË	19	1	138	988	16	1	1								47						1		2							1				6	1221	
MITROVICË E VERIUT																																				0
N. BËRDË			19	9																																28
OBILIQ			12	92	2					2							1																		1	110
PARTESH																																				0
PEJË	30		381	1082	13			1							51							1							1		3	1			1564	
PODUEVË	85	3	98	214	16					1													1				1		2						421	
PRISHTINË	78	6	264	1419	61	7	6	1		16	2		1			10			19	1						2		1	2	2	5	1		1	1905	
PRIZREN	4	1	152	1207	16	1								1	7		1												4					4	1402	
RAHOVEC			15	116	9										3	1			1				1		1						3			1	151	
RANILLUG																																				0
SHTËRPCE										1								1																	4	
SHTIME	7		126	169	6											2		1																	311	
SKËNDERAJ		2	28	135	13	2	1			2		1			3																				187	
SUHAREKË	3		208	772	16	1									1																	4			1005	
VITI		1	36	275	11			0	1															1								1			326	
VUSHTRRI		1	2	129	5										29			1			1							3		1					172	
Z. POTOK																																				0
ZVEÇAN																																				0
BURGU I LIPJANIT																																				0
PA ADRESË																																				0
Gjithshj	307	26	2209	9755	278	20	19	2	2	45	2	2	1	1	182	54	5	3	29	1	4	1	5	1	1	3		20	6	41	8	28	30		13,092	
*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza																																				

*Sëmundjet tjera ngjitëse: , Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza

3. RASTET E SPITALIZUARA NË KLINIKËN INFEKTIVE, PEDIATRISË DHE SPITALET E PËRGJITHSHME, KORRIK 2026

Gjatë kësaj periudhe janë raportuar 488 raste të hospitalizuara si pasojë e sëmundjeve ngjitëse. Numri më i madh i rasteve të hospitalizuara siç shihet në tabelën nr.3 është raportuar nga diarretë akute dhe gastroenterokolitet, të pasuara nga pneumonitë dhe infeksionet viraledhe bakteriale të traktit respirator. Vetëm një pjesë e këtyre rasteve kanë konfirmim laboratorik të shkaktarit, ndërsa rastet tjera raportohen sipas pasqyrës klinike (shih Tabela 3).

Tabela 3. Rastet e hospitalizuara me sëmundje ngjitëse në Klinikën Infektive, Pediatriisë dhe spitalet e përgjithshme, korrik 2026

Sëmundja	Numri i rasteve
Pneumonia /ARI	58
SARI	26
Sindroma meningjeale	23
Helmimet me ushqim	30
Diarrea akute dhe gastroenterocolite	308
Status febrilis	27
Exanthema	2
Mononucleosis	5
Erysipela	9
Gjithsej	488

4. EPIDEMITË E RAPORTUARA GJATË MUAJIT KORRIK 2026

Epidemia alimentare në komunën e Junikut

Më datë 01.07.2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Gjakovë ka raportuar epidemi alimentare me diagnozë Intoxicatio alimentaris në komunën e Junikut. Sipas të dhënave epidemiologjike, fillimi i epidemisë daton më 27.06.2026, ndërsa epidemia ka përfunduar më 21.07.2026. Nga 14 personat e anketuar 5 kanë qenë të sëmurë, 3 të dyshimtë dhe 6 raste grup kontrollë. Nga rastet e sëmura 5 apo 100% i përkasin gjinisë mashkullore, kurse sa i përket grupmoshës: 2 janë të moshës 22 vjeç, dhe nga 1 të moshave 12, 30 dhe 88 vjeç. Të sëmurët kanë konsumuar ushqim në lokacionin në fjalë me date 27.06.2026 dhe rastet e para fillojnë të kenë simptome 8 orë pas konsumimit të ushqimit, piku vërehet me date 28.08.2026 në orët e mbrëmjes. Koha mesatare e inkubacionit 18.7 orë (min 8 orë, max 24.30 orë). Sa i përket simptomave të sëmundjes, të gjithë kishin dhembje barku, dhe diarre ujore dhe nga 4 apo 80% vjellje dhe temperature të lartë/ethe. Nga 5 rastet e sëmura, dy (40%) janë trajtuar në mënyrë hospitalore, kurse 3 tjera ambulantore. Burimi i infeksionit është vlerësuar i panjohur, ndërsa rruga e transmetimit është identifikuar si e papercaktuar.

Gjatë hulumtimit epidemilogjik në teren, janë marr nga pacientët dy mostra fecesi të cilat janë testuar në koprokulturë, parazit dhe Rota/Adenovirus dhe të cilat kanë rezultuar negative.

Epidemia alimentare me Salmonella Enteritidis në rajonin e Prishtinës

Më datë 10.07.2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Prishtinë është njoftuar nga Klinika Infektive e QKUK-së dhe Inspektorati Sanitar për paraqitjen e rasteve me simptoma gastrointestinale të lidhura epidemiologjikisht me konsumimin e ushqimit në një lokal ushqimor në rajonin e Prishtinës. Sipas të dhënave epidemiologjike, fillimi i epidemisë daton më 09.07.2026, ndërsa bazuar në mbikëqyrjen epidemiologjike dhe mungesën e rasteve të reja pas kalimit të periudhës së inkubacionit, epidemia konsiderohet e përfunduar më 20.07.2026.

Bazuar në hulumtimin epidemiologjik janë identifikuar 79 raste, të cilat kanë zhvilluar simptomatologji klinike dhe kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Prej tyre, 30 raste (37.97%) janë hospitalizuar, ndërsa 49 raste (62.03%) janë trajtuar në mënyrë ambulatorë. Nuk janë raportuar raste me përfundim fatal. Burimi i infeksionit është vlerësuar si i dyshuar, me lidhje të fortë epidemiologjike me konsumimin e ushqimit në lokalin e hetuar, ndërsa rruga e transmetimit është alimentare, përmes konsumimit të ushqimit të kontaminuar.

Për qëllime diagnostike dhe epidemiologjike janë marrë 8 mostra ushqimore, 3 strisho nga mjedisi i punës dhe personeli, si dhe 14 mostra fecesi nga pacientët e hospitalizuar. Në mostrat e fecesit është izoluar Salmonella Enteritidis, duke konfirmuar shkaktarin etiologjik të epidemisë. Në mostrat ushqimore dhe në strishot e marra nuk është izoluar Salmonella spp., megjithëse në disa mostra ushqimore janë evidentuar ngarkesa të rritura bakteriale. Rezultatet laboratorike, të interpretuara së bashku me të dhënat klinike dhe epidemiologjike, janë në përputhje me shpërthimin epidemik dhe mbështesin lidhjen e tij me konsumimin e ushqimit në lokalin e hetuar, ndonëse burimi specifik i kontaminimit nuk është konfirmuar laboratorikisht.

Rastet kanë paraqitur simptomatologji tipike të gastroenteritit akut, kryesisht diarre, të vjella, dhimbje barku dhe temperaturë/ethe. Sipas gjinisë janë raportuar 46 raste (58.23%) të gjinisë femërore dhe 33 raste (41.77%) të gjinisë mashkullore. Grupmosha më e prekur është ajo 20-29 vjeç, me 31 raste (39.24%), e ndjekur nga grupmosha 30-39 vjeç me 15 raste dhe 10-19 vjeç me 13 raste.

Epidemia alimentare me Salmonella Enteritidis në Komunën e Hanit të Elezit

Më datë 14.07.2026, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Ferizaj është njoftuar nga DSHMS Hani i Elezit, Klinika Infektive e QKUK-së dhe Inspektorati Sanitar për paraqitjen e rasteve me simptoma gastrointestinale të lidhura epidemiologjikisht me konsumimin e ushqimit në dy lokale ushqimore në Komunën e Hanit të Elezit. Sipas të dhënave epidemiologjike, fillimi i epidemisë daton më 14.07.2026, ndërsa bazuar në mbikëqyrjen epidemiologjike dhe mungesën e rasteve të reja pas datës 16.07.2026, epidemia konsiderohet e përfunduar. Bazuar në hulumtimin epidemiologjik janë identifikuar 110 raste, të cilat kanë zhvilluar simptoma gastrointestinale dhe kanë kërkuar ndihmë mjekësore, nga 420 persona të ekspozuar, duke rezultuar me një shkallë sulmi (Attack Rate – AR) prej 26.2%. Për hulumtim epidemiologjik janë plotësuar 45 anketa epidemiologjike (40.9%). Nga rastet e anketuara, 8 raste (17.8%) janë hospitalizuar, ndërsa 37 raste (82.2%) janë trajtuar në mënyrë ambulatorë. Nuk është raportuar asnjë rast me përfundim fatal.

Nga 420 personat e ekspozuar, rreth 120 persona kanë qenë të ekspozuar në lokalin e parë ushqimor, ndërsa 300 persona në lokalin e dytë ushqimor. Nga 45 rastet e anketuara, 40 raste (88.9%) kanë deklaruar konsumim të ushqimit në lokalin e parë, 3 raste (6.7%) në lokalin e dytë, ndërsa 2 raste (4.4%) kanë deklaruar konsumim të ushqimit në të dy lokalet. Bazuar në të dhënat epidemiologjike dhe laboratorike, burimi i infeksionit është vlerësuar si ushqimi i kontaminuar, me lidhje të fortë epidemiologjike me konsumimin e ushqimit në lokalin e parë, ndërsa rruga e transmetimit ka qenë alimentare, përmes konsumimit të ushqimit të kontaminuar. Për qëllime diagnostike dhe epidemiologjike janë marrë 5 mostra ushqimore (2 nga lokali i parë dhe 3 nga lokali i dytë), 15 strisho nga mjedisi i punës dhe personeli (8 nga lokali i parë dhe 7 nga lokali i dytë), 10 mostra të fecesit nga pacientët dhe 2 mostra uji, nga një për secilin lokal.

Në analizat laboratorike, 5 mostra të fecesit rezultuan pozitive për Salmonella Enteritidis. Në mostrat ushqimore të marra nga lokali i parë u izolua Salmonella spp. në mostrat e majonezës dhe sallatës së lakrës, ndërsa të gjitha mostrat ushqimore të marra nga lokali i dytë rezultuan negative. Analizat fiziko-kimike dhe bakteriologjike të mostrave të ujit rezultuan brenda standardeve për ujë të destinuar për konsum njerëzor, ndërsa në strishot e marra nga mjedisi i punës dhe personeli nuk u izoluan baktere patogjene dhe konfirmojnë Salmonella Enteritidis si shkaktarin etiologjik të epidemisë. Rastet kanë paraqitur simptomatologji tipike të gastroenteritit akut, kryesisht diarre, të vjella, temperaturë, ethe, mundim dhe dhimbje barku. Sipas gjinisë janë raportuar 31 raste (68.9%) të gjinisë mashkullore dhe 14 raste (31.1%) të gjinisë femërore. Sipas grupmoshave, grupi më i prekur ka qenë ai 10–19 vjeç me 27 raste (60.0%), i ndjekur nga grupmosha 20–29 vjeç me 8 raste (17.8%), 30–39 vjeç me 5 raste (11.1%), 0–9 vjeç me 3 raste (6.7%), ndërsa grupmoshat 40–49 vjeç dhe ≥50 vjeç janë përfaqësuar me nga 1 rast (2.2%) secila.

5. RAPORTIMI I SËMUNDJEVE NGJITËSE NGA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PËRMES SMSN KRAHASUAR ME ATE ME KOPJE FIZIKE, KORRIK 2026

Për këtë periudhë, përmes Sistemit të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN) kanë raportuar 28 komuna ose 73.68% (28/38) e tyre. Komunitat të cilat nuk kanë raportuar: Graçanicë, Klokot, Leposaviq, Mitrovicë e veriut, Partesh, Ranillug, Shtërpce, Zvečan dhe Z.Potok. Nga komunitat me shumicë serbe përveç Novo Bërdës, të gjitha komunitat e cekura më lartë, gjithashtu nuk raportojnë as me kopje fizike.

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, korrik 2026

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) ka mandat monitorimin e situatës epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në vend dhe këtë e bënë përmes Sistemit digjital të Mbikëqyrjes së Sëmundjeve Ngjitëse (SMSN).

Megjithatë, raportimi i rasteve në SMSN nga ana e institucioneve shëndetësore ende nuk është në nivel të kënaqshëm.

Bazuar në Sistemin e mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse për periudhën 01/07/2026-31/07/2026, sipas panelit (sidebar) për monitorim të institucioneve raportuese, shprehur sipas indikatorit: 139 institucione kanë raportuar krahasuar me 488 institucione të obligueshme për raportim (apo shprehur në përqindje 28.5%). Ndërsa sipas përlogaritjes së të dhënave nga Departamenti i Epidemiologjisë në IKSHPK, për muajin korrik 2026 janë raportuar gjithsej 13,092 raste me sëmundje ngjitëse. Prej tyre, 8,598 raste të sëmundjeve ngjitëse në Kosovë përmes kopjeve fizike të formularit të raportimit ndërsa përmes SMSN janë raportuar 4,494 raste apo shprehur në përqindje (34.3%) nga numri i përgjithshëm i rasteve. (Tabela 4).

Tabela 4. Raportimi i sëmundjeve ngjitëse nga institucionet shëndetësore përmes SMSN, korrik 2026

Korrik, 2026 me KOPJE FIZIKE										Korrik, 2026 me SMSN													
KOMUNA	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Institucione Private	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	Spitali i përgjithshëm	Klinika Infektive	Klinika e Pediatrisë	Klinika e Dermatovenerologjisë	Klinika e Pulmologjisë	Njësia Shëndetësore e Burgjeve	Institucione Private	QKTGJ	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej	
DEÇAN							169	4		173									48				48
DRAGASH							121	37		158									3				3
DRENAS							30			30									49	9	1		59
F. KOSOVË										0									165	48	87		300
FERIZAJ	21					336	69	167		593							22		44	33	3		102
GJAKOVË										0	20						37		141	57			255
GJILAN	13					112	48	302		475	24								20	80			124
GRAÇANICË										0													0
H. I ELEZIT							61			61									100				100
ISTOG							61	107		168									27	4			31
JUNIK							17			17									52				52
KAÇANIK							190			190									28				28
KAMENICË							49	399		448									33	4			37
KLINË							265			265									10				10
KLOKOT										0													0
LEPOSAVIQ										0													0
LIPJAN										0									21	4	13		38
MALISHEVË										0									143	36			179
MAMUSHË							39			39									30				30
MITROVICË	224						288	111	2	625	23								71	17			111
MITROVICË V.										0													0
N. BËRDË							23			23									6				6
OBILIQ							8			8									80	20	7		107
PARTESH										0													0
PEJË	39						247	984	105	1375	176								72	9			257
PODUJEVË							238		15	253									119	33	8		160
PRISHTINË		200	108				247	105	220	880		88	56	3	1		7	5	76	1346	71		1653
PRIZREN	68					20	467	556	65	1176	59					1	11		92	155			318
RAHOVEC										0							17		69	55	2		143
RANILLUG										0													0
SHTËRPCE										0													0
SHTIME							4	288		292									11				11
SKËNDERAJ							92	36		128									38	13			51
SUHAREKË						99	424	336	40	899							2		13				15
VITI							172	150		322									89	8			97
VUSHTRRI										0	26								24	119			169
Z. POTOK										0													0
ZVEÇAN										0													0
Gjithsej	365	200	108	0	0	567	3329	3582	447	8598	328	88	56	3	1	1	96	5	1674	2050	192		4494

6. SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME SËMUNDJE NGJITËSE NË RAJON DHE BOTË, KORRIK 2026

Patogjenët respiratorë

Gjatë muajit korrik 2026, aktiviteti i viruseve respiratore në vendet e Bashkimit Evropian dhe Zonës Ekonomike Evropiane (BE/ZEE) ka mbetur në nivele të ulëta ndërsezonale. Aktiviteti i SARS-CoV-2 vazhdon të jetë i ulët në shumicën e vendeve evropiane, ndërsa në disa shtete është vërejtur një rritje e lehtë e rasteve të konfirmuara laboratorikisht. Megjithatë, kjo rritje nuk është shoqëruar me rritje të hospitalizimeve, pranimeve në njësitë e kujdesit intensiv apo vdekjeve të lidhura me COVID-19. Varianti XFG vazhdon të jetë dominues në shumicën e vendeve ku kryhet mbikëqyrja gjenomike. Aktiviteti i virusit të Influcencës dhe virusit sincicial respirator (RSV) mbetet gjithashtu në nivele shumë të ulëta dhe nuk ka tregues për fillimin e sezonit të ri respirator. Të dhënat e EuroMOMO kanë treguar një rritje të lehtë të mortalitetit nga të gjitha shkaqet gjatë javëve të verës në disa vende evropiane, veçanërisht në grupmoshat mbi 45 vjeç, por deri më tani nuk ka evidencë që kjo të jetë e lidhur me aktivitetin e viruseve respiratore. ECDC thekson se të dhënat gjatë periudhës verore duhet të interpretohen me kujdes për shkak të numrit më të ulët të mostrave të testuara dhe vonesave në raportim. Monitorimi vazhdon përmes rrjetit ERVISS dhe platformës EpiPulse, me qëllim identifikimin e hershëm të ndryshimeve në qarkullimin e viruseve respiratore. ECDC e përfshiu situatën e viruseve respiratore në përditësimet e CDTR edhe për javën e fundit të korrikut.

EBOLA

Gjatë muajit korrik 2026, shpërthimi i sëmundjes Ebola të shkaktuar nga virusi Bundibugyo në Republikën Demokratike të Kongos (RDK) ka vazhduar të zgjerohet, ndërsa situata në Ugandë është përmirësuar ndjeshëm. Deri më 28 korrik, RDK kishte raportuar gjithsej 3.360 raste të konfirmuara, përfshirë 1.487 vdekje, ndërsa 733 pacientë ishin të hospitalizuar në izolim. Provinca Ituri vazhdon të jetë epiqendra e shpërthimit, me 2.988 raste dhe 1.238 vdekje, ndërsa raste janë raportuar edhe në North Kivu, South Kivu, Haut-Uele dhe Tshopo. Në total, 48 nga 140 zona shëndetësore në pesë provinca janë prekur. Në Ugandë, deri më 17 korrik ishin raportuar 20 raste të konfirmuara, përfshirë dy vdekje, ndërsa nuk janë raportuar raste të reja që nga 21 qershori. Më 28 korrik, Ministria e Shëndetësisë së Ugandës shpalli përfundimin e shpërthimit, pas përfundimit të periudhës së nevojshme të monitorimit epidemiologjik. Gjatë korrikut është raportuar gjithashtu një rast human në një shtetas amerikan që punonte për një organizatë humanitare në RDK dhe i cili u evakuua për trajtim në Gjermani. ECDC vlerëson se probabiliteti i infektimit për popullatën që jeton në BE/ZEE mbetet shumë i ulët, ndërsa monitorimi dhe masat e përgatitjes për rastet e importuara vazhdojnë.

Rast human me Virusin variant A(H3N2) v të Influcencës

Gjatë muajit korrik 2026 është raportuar një rast human i infeksionit me virusin variant të Influcencës A(H3N2)v në Brazil. Rasti është identifikuar tek një fëmijë i hospitalizuar për infeksion respirator akut të rëndë. Hulumtimi epidemiologjik ka evidentuar kontakt të shpeshtë me një fermë derrash, duke e bërë ekspozimin ndaj derrave burimin më të mundshëm të infeksionit. Autoritetet kanë kryer gjurmimin dhe monitorimin e kontakteve familjare dhe të personelit shëndetësor, pa identifikuar raste të tjera të lidhura me këtë ngjarje. Infeksionet humane me viruset variant të Influcencës së derit mbeten sporadike dhe zakonisht lidhen me kontakt të drejtpërdrejtë me derrat ose mjediset e kontaminuara. Deri më tani nuk ka evidencë për transmetim të qëndrueshëm nga njeriu te njeriu, ndërsa rreziku për popullatën e BE/ZEE mbetet i ulët.

Dengue

Gjatë muajit korrik 2026, ECDC ka vazhduar mbikëqyrjen sezonale të Dengues në Evropë, në veçanti në zonat ku është i pranishëm vektori *Aedes albopictus*. Deri në fund të korrikut, Franca mbetet vendi evropian që ka raportuar transmetim autokton të Dengues gjatë këtij sezoni. Krahas rasteve autoktone, shumica e rasteve të raportuara në vendet e BE/ZEE vazhdojnë të jenë të importuara nga udhëtarët që kthehen nga zona endemike në Azi, Amerikën Latine dhe Karaibe. Gjatë periudhës së verës, temperaturat e larta dhe aktiviteti i shtuar i mushkonjave krijojnë kushte më të favorshme për transmetim lokal pas importimit të virusit. ECDC rekomandon forcimin e mbikëqyrjes epidemiologjike dhe entomologjike, diagnostikimin e hershëm të rasteve, kontrollin e vektorëve dhe rritjen e ndërgjegjësimit të profesionistëve shëndetësorë gjatë sezonit të transmetimit.

Chikungunya

Gjatë muajit korrik 2026, infeksionet me virusin Chikungunya kanë vazhduar të përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm të lidhur me udhëtimet ndërkombëtare dhe aktivitetin sezonal të mushkonjave *Aedes* në Evropë. Megjithatë shumica e rasteve në Evropë mbeten të importuara, prania e vektorëve kompetentë dhe temperaturat e larta gjatë muajve të verës rrisin mundësinë e transmetimit lokal pas importimit të rasteve. ECDC ka theksuar gjatë muajit korrik rëndësinë e mbrojtjes nga pickimet e mushkonjave, diagnostikimit të hershëm dhe mbikëqyrjes së rasteve të importuara, veçanërisht në zonat ku *Aedes albopictus* është tashmë i vendosur.

Virusi i Nilit Perëndimor (WEST NILE VIRUS)

Gjatë muajit korrik 2026 është vërejtur një zgjerim i aktivitetit të virusit të Nilit Perëndimor në Evropë. Deri më 22 korrik, janë identifikuar 35 zona të prekura në gjashtë vende evropiane: Itali, Greqi, Rumania, Maqedonia e Veriut, Spanjë dhe Francë. Në këto vende janë raportuar gjithsej 81 raste humane të fituara lokalisht, prej të cilave 46 në Itali, 21 në Greqi, pesë në Maqedoninë e Veriut, pesë në Rumania, tre në Spanjë dhe një në Francë. Numri i zonave të prekura është rritur gjatë muajit, duke reflektuar zgjerimin gradual të sezonit të transmetimit. ECDC vazhdon monitorimin javor të rasteve humane dhe rekomandon forcimin e mbikëqyrjes, kontrollin e vektorëve dhe zbatimin e masave për sigurinë e gjakut dhe substancave me origjinë njerëzore në zonat ku dokumentohet transmetim lokal.

Ethet Hemorragjike Krime–Kongo (EHKK/CCHF)

Gjatë muajit korrik 2026, Spanja ka vazhduar të jetë vendi i vetëm në Bashkimin Evropian ku janë raportuar raste autoktone të etheve hemorragjike Krime–Kongo gjatë këtij sezoni. Deri në fund të periudhës së raportimit janë konfirmuar gjithsej dy raste. Nuk janë raportuar raste të reja gjatë javës së fundit të korrikut. Situata monitorohet nga ECDC në kuadër të mbikëqyrjes sezonale, veçanërisht për shkak të aktivitetit të rriqrave të gjinisë *Hyalomma*, të cilët janë vektorë të rëndësishëm të virusit. Vigjilenca epidemiologjike mbetet veçanërisht e rëndësishme në zonat ku ekziston prania e rriqrave dhe ekspozimi i popullatës gjatë aktiviteteve në natyrë.

Malaria

Gjatë muajit korrik 2026, autoritetet shëndetësore gjermane kanë raportuar raste të malaries nga *Plasmodium falciparum* tek persona të punësuar në Aeroportin Ndërkombëtar të Frankfurtit, pa histori udhëtimi në zona endemike. Ngjarja është vlerësuar si e mundshme për t'u lidhur me fenomenin e njohur si “malaria e aeroportit”, ku mushkonja të infektuara mund të transportohen nëpërmjet avionëve nga zona endemike. Hetimi epidemiologjik dhe entomologjik ka përfshirë monitorimin e zonës aeroportuale dhe analiza për përcaktimin e origjinës së mundshme të parazitit. Raste të tilla janë shumë të rralla në Evropë, por kërkojnë vigjilencë të lartë epidemiologjike, pasi mungesa e historisë së udhëtimit mund të vonojë diagnostikimin. ECDC e përfshiu ngjarjen në monitorimin e kërcënimeve infektive gjatë korrikut.

Shpërthim Epidemik me *Salmonella* në Lamia, greqi

Gjatë muajit korrik 2026, në qytetin e Lamias në Greqi është hetuar një shpërthim i infeksionit nga *Salmonella*. Hetimi filloi pas identifikimit të një numri të shtuar të rasteve me diarje, të vjella dhe temperaturë, të cilat kishin kërkuar trajtim në Spitalin e Përgjithshëm të Lamias. Deri më 17 korrik janë raportuar 25 raste të konfirmuara laboratorikisht, ndërsa shumica e rasteve kanë qenë persona të rinj. Hetimi epidemiologjik ka evidentuar konsumimin e mishit të pulës në pika të ndryshme të shërbimit ushqimor para shfaqjes së simptomave dhe autoritetet kanë kryer kontrole në restorante dhe në zinxhirin e furnizimit. Më vonë gjatë hetimit është identifikuar *Salmonella* edhe në produkte të pulës nga furnizues të tjerë, duke zgjeruar hetimin ushqimor. Autoritetet greke kanë ndërmarrë masa për tërheqjen e produkteve të dyshuara dhe kanë vazhduar hetimet epidemiologjike dhe laboratorike. Ky shpërthim është një ngjarje kombëtare e raportuar nga autoritetet greke dhe jo një vlerësim i veçantë i ECDC-së.

Situata epidemiologjike me Virusin e Nilit Perëndimor në Maqedoninë e veriut

Gjatë muajit korrik 2026, Maqedonia e Veriut ka vazhduar të raportojë raste të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor. Sipas të dhënave të publikuara më 27 korrik, në vend janë regjistruar gjithsej tetë raste, prej të cilave shtatë janë klasifikuar si të konfirmuara dhe një si i mundshëm. Gjashtë raste janë konsideruar autoktone dhe janë identifikuar në zonat e Shkupit dhe Velesit, ndërsa një rast nga Shkupi ka pasur histori udhëtimi në Greqi, por periudha e inkubacionit ka përfshirë edhe qëndrimin në Maqedoninë e Veriut. Shumica e rasteve janë regjistruar tek personat mbi 60 vjeç. Nga tetë rastet, shtatë kanë qenë meshkuj dhe një femër. Të gjitha rastet e raportuara gjatë vitit 2026 kanë paraqitur formë neuroinvazive dhe kanë kërkuar hospitalizim. Pesë raste kanë pasur fillim të simptomave gjatë muajit korrik, dy gjatë qershorit dhe një gjatë majit. Maqedonia e Veriut është gjithashtu ndër gjashtë vendet evropiane me zona të prekura nga WNV gjatë sezonit 2026, me pesë raste humane të fituara lokalisht deri më 22 korrik sipas ECDC-së.

7. REKOMANDIMET

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave në kohë reale, të dhëna kualitative dhe pasqyrë reale të situatës epidemiologjike për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

INSITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË

PUBLIKE TË KOSOVËS

Departamenti i Epidemiologjisë

Adresa: R. Instituti Shëndetësor Nr. 12, Prishtinë 10000

WebFaqe: <http://www.ikshpk.rks-gov.net>

E-mail: QOE.IKSHP@rks-gov.net

Telefoni+38338 541432

